

**BEQIR META****DEBATI SHQIPTARO-GREK PËR PROBLEMET  
E MINORITETEVE DHE TË KISHËS AUTOQEFALE  
SHQIPTARE NË ORGANIZMAT NDËRKOMBËTARE  
NË VITET 1929-1934**

Në vitin 1928 pas shpalljes së Monarkisë fillonte një fazë e re e përpjekjeve për konsolidimin e mëtejshëm të shtetit shqiptar. Pjesë integrale e këtij procesi do të ishte edhe konsolidimi i institucioneve arsimore e fetare thelbi i të cilit ishte kombëtarizimi i tyre. Ky proces i natyrshëm dhe legjitim për një shtet kombëtar ndeshi në një kundërshtim dhe presion të fuqishëm nga ana e shteteve fqinje, Jugosllavisë dhe Greqisë të cilat, duke i trajtuar proceset e afirmimit të vazhdueshëm të institucioneve kombëtare shqiptare si probleme minoritetesh dhe si shkelje të së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e minoriteteve, u përpoqën të mobilizonin edhe organizmat ndërkombëtare të kohës për t'i penguar ato ose, më së paku, për t'u dhënë atyre një drejtim tjetër, i cili nuk çonte në konsolidimin e shtetit shqiptar.

Pas daljes së ligjit mbi komunitetet fetare në vitin 1929, qeveria greke kundërshtoi me forcë karakterin homogjenizues të këtij ligji. Por, edhe përfaqësuesit britanik në Durrës e vlerësuan atë në mënyrë kritike. I Ngarkuari me Punë i Mbretërisë së Bashkuar, S. R. Jordan, i shkruante Forin Ofisit, se “me këtë ligj, qeveria shqiptare mori nën kontroll të plotë të gjithë komunitetet fetare, deri në atë shkallë sa të emërojë dhe shkarkojë klerin dhe funksionarët e tjerë, financat e komuniteteve dhe deri diku, liturgjinë e tyre fetare, e cila duhet të jetë e mbushur me patriotizëm”. Në fakt, kjo ishte një paraqitje e ekzagjeruar e përmbajtjes së ligjit të ri i cili synonte të shmangte ndikimin e huaj mbi institucionet fetare të vendit, duke respektuar në mënyrë të barabartë pavarësinë e tyre. Sipas Jordan, ishte e vështirë që, në kuadrin e këtij ligji, të kuptohej se si mund të arrihej ndonjë afrim midis qeverisë shqiptare nga njëra anë, dhe Vatikanit e Fanarit nga ana tjetër. Ai pohonte se elementët myslimanë të shtetit ishin shumë të shqetësuar se deri në çfarë shkalle qeveria synonte të kontrollonte vakëfet e tyre dhe, megjithëse komentet publike lidhur me dekretin kishin qenë shumë të kufizuara dhe ato në shtyp ishin ndaluar,

ligji ishte pritur dukshëm në mënyrë të pafavorshme, gjë që pa dyshim do të manifestohej kur ai do të zbatohet në gjashtëmujorin e ardhshëm. Diplomati i lartpërmendur britanik kishte zhvilluar një bisedë me një koleg të ambasadës greke, i cili i kishte thënë se: “megjithëse ishin bërë përpjekje për të modifikuar situatën e pakënaqshme që ishte krijuar me formimin e kishës ortodokse autoqefale shqiptare dhe, pavarësisht nga fakti se qeveria shqiptare dhe në veçanti Mbreti, kishin pranuar çmendurinë e vendosjes në krye të Sinodit, të një personi të njohur për karakterin e keq, siç ishte Visarioni, ishte bërë pak progres dhe ndonjë shpresë që kishte ekzistuar më parë për një zgjidhje ishte shuar tashmë nga ligji i ri”. Përfaqësuesi britanik mendonte gjithashtu se përpjekjet sporadike të qeverisë shqiptare për të arritur një konkordat me Vatikanin do të dështonin në mënyrë të paevitueshme për arsye të dispozitave të dekretit të ri.<sup>1</sup>

Edhe disa muaj më vonë dhe pikërisht në shkurt të vitit 1930 përfaqësuesit britanikë në Shqipëri konstatonin se tashmë perspektivat për arritjen e një marrëveshjeje midis Fanarit dhe KOASH ishin më pak të favorshme. Ministri britanik, Hodgson i raportonte Londrës se ministri grek në Shqipëri, Melas ishte shumë i zemëruar për atë që ai e quante pabesi të shqiptarëve lidhur me qëndrimin që ata kishin mbajtur ndaj marrëveshjes së arritur në Athinë midis Vasil Avramit dhe Krisanthosit. Sipas tij kjo marrëveshje më parë ishte mirëpritur si nga Rauf Fico ashtu edhe nga Mbreti të cilët kishin shprehur kënaqësinë e tyre për këtë akord. Gjithashtu, po sipas Melas-it, edhe Vasil Avrami e kishte lavdëruar qëndrimin e arsyeshëm që kishte treguar Fanari gjatë bisedimeve. Por sapo Avrami ra nën influencën e Koço Kotës ai kishte filluar të ndryshonte qëndrim dhe tendenca e mëparshme për mirëkuptim me Fanarin kishte filluar të dobësohej. Tani komisioni i emëruar nga qeveria shqiptare për të vijuar negociatat për këtë çështje, kishte hedhur poshtë një kusht integral të marrëveshjes së Athinës, pikërisht përcaktimin që parimi i trajtimit si minoritet, ashtu siç kuptohej në Gjenevë, të shtrihej edhe mbi shqiptarët ortodoksë në këtë vend. Përveç kësaj, kur ishte në Athinë, Vasil Avrami kishte pranuar që peshkopi i Malit Athos, Kurilas i cili ishte me origjinë shqiptare dhe njëkohësisht edhe një figurë e rëndësishme në hierarkinë ortodokse, të zëvendësonte peshkopin

---

<sup>1</sup> Foreign Office (më tej: FO) 286/1044, S. R. Jordan nga Durrësi për A. Henderson, 21 shtator 1929.

Visarion Xhuvani, si kryetar të KOASH. Tashmë komisioni kishte deklaruar se ky emërim nuk do të ishte i pranueshëm dhe përparësia do t'i jepej peshkopit Joakim të Kozanit. Melas i cili ishte i bindur se kreun e KOASH duhej ta emëronin grekët, e konsideronte peshkopin Joakim asgjë më shumë se sa një shërbëtor të italianëve. Ai i fajësonte shqiptarët se edhe në këtë çështje, si për të gjitha çështjet e tjera, po bënë ato që dëshironin ustallarët e tyre italianë. Sipas tij kjo ishte e gjitha pjesë e një skeme për ta çuar ortodoksinë shqiptare drejt uniatizmit, duke zëvendësuar Fanarin me Vatikanin. I pyetur nga Hodgson, Melas kishte deklaruar se Greqia nuk do të vinte në jetë qëllimet e saj të mira për kompensimin e pronave që shqiptarët kishin në Greqi, për sa kohë që shqiptarët do të mbeteshin në këto pozita në çështjen e kishës. Në fakt më e arsyeshme është të besojmë se qeveria greke kishte vendosur të mos u jepte asgjë shqiptarëve për pronat që u kishte konfiskuar. Për më tepër, ajo kishte vendosur ta përdorte këtë çështje si mjet presioni për të dekurajuar qeverinë shqiptare në procesin e sendërtimit të institucioneve kombëtare. Nëse ky presion nuk do ta ndalte këtë kurs kombëtar, atëherë ai, me siguri, do të sillte tensione të brendshme midis qeverisë shqiptare dhe shtetasve shqiptarë të interesuar për kompensimin e pasurive të tyre dhe në radhë të parë të disa pronarëve të mëdhenj e të fuqishëm të vendit që kishin prona në Greqi. Por Melas, sigurisht, që ishte aq i zgjuar sa të mos i thoshte asgjë nga këto kolegut britanik. Ai u përpoq ta mashtronte atë, duke lënë të kuptohej se grekët ishin ende të hapur për një marrëveshje. Në këmbim të lëshimeve që shqiptarët do të bënin në fushën fetare, grekët do të bënin lëshime në çështjet shekullare.

Hodgsoni pyeti dhe Rauf Ficon për mundësinë e arritjes së një mirëkuptimi me grekët por ky u tregua pesimist. Fico këmbënguli se kërkesa për trajtimin e ortodoksëve si një minoritet nuk kishte qenë fiksuar në marrëveshjen origjinale midis Avramit dhe Krisanthosit, por ajo ishte bërë më vonë nga qeveria greke. Melasi kishte justifikuar kërkesën për trajtimin e ortodoksëve shqiptarë si një minoritet, me faktin se, Fanari nuk do të tërhiqej prej saj për arsye prestigji, pasi kisha shqiptare mund të kishte një status që do ta ndalonte atë të ndërhynte në çështjet e bashkëfetarëve të vet.

Fico i bëri të qartë Ministrin britanik se qeveria shqiptare kishte gjithashtu detyrimet e saj kundrejt minoritetit shqiptar në Greqi. Megjithatë shkollat e minoritetit grek funksiononin rregullisht, Athina zyrtare ishte ankuar se shkollat greke në Shqipëri ishin mbyllur. Ndërsa

shqiptarët në Greqi nuk kishin asnjë shkollë dhe qeveria greke nuk kishte se çfarë të mbyllte. Në qoftë se Shqipëria do të plotësonte këtë kërkesë të Fanarit, ajo do ta linte çështjen e minoritetit tërësisht në duart e qeverisë greke dhe nuk do të përfitonte asgjë si këmbim. Si mundej ai ta justifikonte këtë lëshim para Dhomës së Deputetëve?

Gjithashtu ai u ankua se çështjet nuk ishin bërë më të lehta për arsye të personalitetit të Melasit, i cili ishte aq shumë nervoz sa që një diskutim i qetë me të ishte i pa mundur dhe, për më tepër, ai ishte i brumosur me doktrinën se të gjithë ortodoksit ishin grekë.

Hodgsoni theksonte se Mbreti Zog ishte treguar më sanguin se sa Ministri i Jashtëm i tij. Ai kishte thënë se marrëveshja ishte bllokuar me ndërhyrjen e tij. Të gjithë ministrat e tij kishin qenë në favor të pranimin të marrëveshjes Avrami-Krisanthos deri sa ai u kishte thënë atyre se Fanari, me këmbënguljen e tij për trajtimin si minoritet të ortodoksëve në Shqipëri, po pushtonte një terren politik. Mbreti kishte thënë se ai nuk kishte asgjë kundër zbatimit të parimit të minoriteteve në mënyrë reciproke. Por Fanari nuk kishte asgjë që mund të jepte. Kështu që, qeveria greke duhej të tregojë e hapur ndaj kësaj çështjeje dhe qeveria shqiptare do t'i diskutonte me kënaqësi çështjet minoritare me të në bazë të lëshimeve reciproke. Ai u kishte thënë grekëve se ishte i përgatitur që, në një moment, të dërgonte një delegacion për të diskutuar rreth këtij problemi dhe të gjitha çështjeve që ishin në diskutim, gjithashtu edhe për të negociuar një traktat të miqësisë dhe arbitrazhit. Nëse ata do ta praninin ose jo këtë propozim kjo mbetej për t'u parë.

Nga këto të dhëna del qartë se pala shqiptare ishte e gatshme të bënte kompromise të mëdha. Megjithëse nuk është shumë e qartë se deri ku do shkonin lëshimet e qeverisë shqiptare, pasi dialogu shqiptaro-grek nuk ishte futur ende në një fazë konkrete, dukej se lëshimet mund të ishin të gjëra dhe mund të shkelnin edhe ndonjë kufi që qeveritë shqiptare, deri në këtë kohë, nuk e kishin kapërcyer. Ky predispozicion synonte që të mbyllte sa më parë dhe përfundimisht debatin dhe fërkimet me Greqinë fqinje. Por kjo politikë luajale nuk gjente përgjigje tek pala greke e cila ishte e fokusuar në synimet e saj shoviniste për të penguar procesin e sendërtimit të shtetit kombëtar shqiptar dhe për deformimin e karakterit të tij nacional. Ajo me këmbëngulje dhe me një program të përcaktuar qartë po ndërhynte në çështjet e brendshme të tij duke mos bërë asnjë kompromis dhe tërheqje në këtë drejtim.

Hodgsoni i shkruante Forin Ofisit: “grekët e kishin keqpërdorur çështjen e kishës ortodokse në Shqipëri një vit më parë dhe ishin duke përsëritur përsëri këtë gabim. Duket tërësisht e pamundur se ata do të shkëputeshin nga një mentalitet i tillë i cili, pothuajse, e pengonte mundësinë e një mirëkuptimi me shqiptarët sepse, me qëndrimin e tyre, ata konfirmonin dyshimin e shqiptarëve se Patriarkati Ekumenik ishte thjeshtë një maskë, nëpërmjet të cilit, qeveria greke fliste kur ajo dëshironte të afirmonte influencën e saj në Shqipërinë e Jugut. Kështu kërkesa për të drejtat e minoriteteve në Greqi, në këmbim të të drejtave analoge që do t’i jepeshin minoritetit grek në Shqipëri, pa dyshim tingëllonte si komike, për arsyen e thjeshtë se grekët e Shqipërisë nuk dukej se kishin ndonjë nevojë për përkujdesjen e qeverisë greke. Megjithëse kërkesa për reciprocitet në vetvete ishte logjike, grekët, duke refuzuar që ta pranonin këtë, po paragjykonin shansin e tyre për të arritur një zgjidhje të problemit të kishës i cili do të bënte një rrugë të gjatë derisa të arriheshin dëshirat e tyre, për të rënë dakord në krijimin e një sinodi të pranueshëm nga Fanari, ashtu si dhe në zgjidhjen e çështjes së zgjatur të gjuhës së liturgjisë në vija të arsyeshme. Me kryeneçësinë e tyre dhe me nervozizmin e Melasit, ata, sipas mendimit tim, po e çojnë akoma më afër atë eventualitet të cilin ata e konsideronin kaq alarmant - pikërisht kalimin e ortodoksëve shqiptarë drejt Uniatizmit.”<sup>2</sup> Këto komente të Hodgsonit ishin mjaft realiste dhe zbulojnë shkaqet reale të tensionit në marrëdhëniet shqiptaro- greke. Megjithatë Hodgsoni, siç e kemi theksuar më lart, nuk e kishte kuptuar se kjo politikë e ashpër ndërhyrjeje dhe presioni kishte edhe objektiva të tjera të mirëpërcaktuara dhe ishte mjaft e dobishme për strategjinë nacionaliste të shtetit grek kundrejt Shqipërisë. Gjithashtu, ai nuk e kishte kuptuar se, pavarësisht nga presioni grek dhe nga ndonjë lëvizje e sinqertë apo me frymëzim të huaj për të kaluar në uniatizëm, shqiptarët ortodoksë, në shumicë, ishin të përkushtuar të ushtronin besimin e tyre shekullor dhe pjesa më e avancuar e tyre ishte në lëvizje për të konsoliduar kishën autoqefale shqiptare si një institucion kombëtar dhe i pastër ortodoks.

Në verën e vitit 1930 përfaqësia britanike në Tiranë informoi Forin Ofisin se ishte krijuar një mundësi që grekët dhe shqiptarët të zgjidhnin mosmarrëveshjet e tyre për çështjen e kishës ortodokse. Kjo mund të çonte në dhënien e Tomosit nga Fanari për KOASH. Por mbeteshin ende

<sup>2</sup> FO 371/14302, Sër R. Hodgson nga Durrësi për A. Anderson, 25 dhjetor 1930.

dy çështje të pazgjidhura, çështja e personelit të Sinodit dhe kërkesa e Fanarit që Shqipëria të premtonte se do t'i trajtonte si minoritet ortodoksët shqiptarë. Për sa i përkiste përbërjes së Sinodit, Fanari kërkonte që të emëronte tre nga pesë anëtarët e tij. Meqë peshkopi Kurilas kishte qenë i papranueshëm, Fanari kishte aprovuar peshkopët Joakim dhe Kissi. Shqiptarët nga ana e tyre kishin deklaruar se pranonin të përjashtonin nga Sinodi Visarionin dhe peshkopin Eugjenios (Eftim), por kërkonin që, për një farë kohe, derisa çështjet të zgjidheshin plotësisht, peshkop Ambrozi i Gjirokastrës të ishte kryetar i përkohshëm i Sinodit. Kështu vështirësia qëndronte për vendin e tretë të Sinodit. Shqiptarët theksonin se, me gjithë dëshirën e tyre për marrëveshje, ata kishin disa limite deri ku mund të bënin lëshime. Ata mund të viheshin në vështirësi përballë ultra nacionalistëve, të cilët mund të ngrinin alarmin kundër pranimit të gjithë kushteve të Patriarkanës, duke e vlerësuar këtë si akt të një dorëzimi servil. Me gjithë këtë qeveria shqiptare ishte treguar e gatshme të jepte garanci verbale që, pas tre muajsh nga nënshkrimi i marrëveshjes, ajo do të zëvendësonte edhe një anëtar tjetër të sinodit aktual me Kotokon i cili ishte përzgjedhur nga Patriarkana.

Melas vijonte të ishte aktiv, duke qenë njëkohësisht shumë vigjilent ndaj italianëve. Ai po i mbante sekret këto bisedime për arsye se besonte që, në se italianët do të informoheshin për to, atëherë ata do të pengonin arritjen e një marrëveshjeje. Ai i kishte thënë Hodgsonit se kishte propozuar formulën e shqiptarëve si mjet për të kapërcyer vështirësinë e krijuar nga kërkesa e Patriarkanës për trajtimin e ortodoksëve shqiptarë me statusin e minoritetit. Gjithashtu ai besonte se oferta e shqiptarëve për t'i dhënë dy vende në Sinod personave të emëruar nga Patriarkana ishte e vlefshme për t'u marrë në konsideratë, edhe në qoftë se premtimi për të dhënë një vend të tretë nuk do të mbahej. Duke folur në parim, ai ishte shprehur se më mirë të merrej ajo që mund të merrej për momentin, megjithëse kjo mund të mos ishte plotësisht e kënaqshme, se sa të pritej për të marrë gjithçka në të ardhmen e cila nuk dihej se si do të ishte. Veçanërisht dukej se aftësia e Fanarit për plotësimin e dëshirave të tij, duke këmbëngulur, më shumë do të venitej se sa do të forcohej. Ai ishte i bindur për faktin se, në realitet, shqiptarët ishin zotër të situatës, përderisa

çfarëdo koncesioni që do të bënin në këtë kohë me qëllim që të siguronin Tomosin, ata mund ta hidhnin poshtë nesër kur Tomosi të ishte siguruar.<sup>3</sup>

Ndërkohë që ishte e angazhuar në luftën kundër krijimit dhe jetësimit të KOASH në Shqipëri, qeveria greke kishte toleruar dhe nxitur bandat kriminale që të terrorizonin Çamërinë. Konsulli britanik në Korfuz, Keane gjatë vizitës që bëri në Epir, vëzhgoi intensivisht situatën atje. Ai shkruante se, veprimtaria e bandave kishte preokupuar banorët e Çamërisë, në atë shkallë, sa që në bisedat me ta nuk kishte vend për tema të tjera diskutimi dhe se “fatkeqësisht biseda e përbashkët në Epir, në kafene dhe kudo, ishin fjalët: brigandët, hajdutët, krime, dhe vrasje të cilat përsëriten në një frekuencë monotone.” Keane informonte Londrën se autoritetet greke e kishin paraqitur gjendjen si të shkëlqyer dhe ishin munduar ta mashtronin.<sup>4</sup>

Ndërkohë vijonte politika e presionit administrativ dhe ekonomik të autoriteteve greke ndaj popullsisë shqiptare të Çamërisë. Me 28 shkurt 1930 banorët e Paramithisë i dërguan një peticion Lidhjes së Kombeve ku ankoheshin për masat e shpronësimit që kishin marrë ndaj pasurive të tyre qeveria greke.<sup>5</sup> Në maj të atij viti popullsia e Dragumit ju drejtua sërish Lidhjes së Kombeve për të njëjtën arsye.<sup>6</sup> Protesta e tyre u përsërit edhe një vit më vonë por Këshilli i LK nuk ndërmori asnjë veprim, vetëm se e arkivoi këtë ankesë. Komisioni i të Treve që e shqyrtoi këtë çështje, i cili përbëhej nga përfaqësues të Venezuelës, Japonisë dhe Polonisë, mori parasysh shpjegimet e qeverisë greke, se ajo kishte marrë masa për zgjidhjen e problemeve të krijuara dhe ishte përpjekur për ta përmirësuar situatën e këtij minoriteti, sa më shumë që të ishte e mundur. Kështu, nga 100 familje të instaluar në tokat e këtij fshati, vetëm 10 ishin nga refugjatët grekë. Për më tepër, këta të fundit po transferoheshin në Maqedoni, gjë që, sipas qeverisë greke, provonte se akuza për trajtim të diferencuar të elementit grek që ishte bërë nga popullsia shqiptare, ishte tërësisht e pathemeltë. Komiteti i të Treve e konsideroi të besueshëm këtë

<sup>3</sup> FO 371/14302, Sër R. Hodgson nga Durrësi për Arthur Henderson, 2 korrik 1930.

<sup>4</sup> FO 286/1044, Telegram i konsullit britanik në Korfuz, Keane, 30 shtator 1929.

<sup>5</sup> FO 371/14391, Peticion i banorëve të Paramithisë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të LK, 28 shkurt 1930.

<sup>6</sup> FO 371/14391, Peticion i banorëve të Dragumit dërguar LK, dhe nota e Sekretarit të Përgjithshëm të LK, Gjenevë, 15 shtator 1930.

shpjegim dhe vendosi që ta mbyllte këtë çështje.<sup>7</sup> Të njëjtën gjë bëri Komiteti i Minoriteteve me kërkesën tjetër të banorëve të Paramithisë. Ata ankoheshin se ishin shpronësuar në kundërshtim me ligjin grek i cili kishte vendosur si kufi shpronësimi pronat mbi 30 ha. Komiteti pranoi si të vlefshme justifikimet e qeverisë greke se shpronësimi i tyre ishte bërë në bazë të ligjeve greke dhe se tani Parlamenti grek kishte miratuar një ligj i cili do ta përmirësonte pozitën e këtyre banorëve.<sup>8</sup>

Në mars të vitit 1932 Komiteti i Minoriteteve mbylli dhe çështjen tjetër të ngritur nga disa banorë të Filatit dhe nga vise të tjera të Çamërisë të cilët ishin ankuar se, megjithëse qeveria greke kishte njohur vlefshmërinë e fermaneve të Perandorisë Osmane, disa fshatra në Filat dhe në Çamëri ishin shpronësuar në mënyrë arbitrare. Menjëherë pas okupimit grek, tokat e tyre ishin zënë nga fshatarë grekë të cilët i kishin ende në zotërim. Qeveria greke u përgjigj se çështja kishte të bënte me 16 fshatra në rajonin e Filatit të banuara nga 20.000 persona me origjinë greke të cilët, nën regjimin turk, kishin qenë detyruar t'u paguanin krerëve të vendit, pasardhës të dy familjeve shqiptare, një tribut (agallëk) në këmbim të mbrojtjes nga bandat shqiptare. Me që përpjekjet e këtyre krerëve për të fituar njohjen e një titulli pronësie mbi këto fshatra nuk kishin pasur sukses, Sulltani kishte nxjerrë në vitin 1863 një ferman që përcaktonte administrimin e fshatrave në një modus vivendi por që e kishte lënë çështjen të hapur. Komiteti mbeti i kënaqur me këto shpjegime dhe më tej, gjithashtu, u kënaq me lajmet e botuara në shtypin grek se qeveria greke kishte marrë masa humanitare në favor të shqiptarëve që ishin ankuar për këtë çështje.<sup>9</sup> Po në këtë mënyrë, Komiteti i Minoriteteve veproi duke mbyllur edhe një sërë çështjesh të tjera të ngjashme ku ankesat e pjesëtarëve të pakicës shqiptare në Greqi nuk u morën parasysh dhe, në bazë të rregulloreve të tij, Komiteti i Minoriteteve vendosi që ato as të mos i paraqiteshin Këshillit të LK. Kështu u veprua me ankesat e banorëve të Pargës, Janinës etj.<sup>10</sup>

Banorët e Pargës, gjithashtu, u ankuan se, qysh prej vitit 1924, autoritetet greke u kishin zënë xhamitë dhe objektet e pronat e tjera

<sup>7</sup> FO 371/15240, Letër e përfaqësuesve të Venezuelës, Japonisë dhe Polonisë për Sekretarin e Përgjithshëm të LK, 14 prill 1931.

<sup>8</sup> Po aty.

<sup>9</sup> FO 371/15970, Letër e përfaqësuesve të Japonisë, Gjermanisë dhe Polonisë për Sekretarin e Përgjithshëm të LK, 19 shkurt 1932.

<sup>10</sup> Po aty.

fetare. Komiteti i Minoriteteve vendosi që ta shtynte diskutimin e kësaj çështje për faktin se qeveria greke kishte deklaruar se ajo nuk mund të hynte në diskutimin e saj përderisa ankuesit i përkisnin një grupi familjesh, karakteri minoritar i të cilave ishte kontestuar më parë. Kuptohet qartë se ky ishte një qëndrim tërësisht jo legjitim i qeverisë greke i cili ishte i dënueshëm nga Traktatet e Minoriteteve por kjo politikë asimiluese dhe shtypëse u lejua nga Lidhja e Kombeve dhe organizmat e saj për shkak të klimës politike ndërkombëtare të asaj kohe. Më tej qeveria greke informoi se personat e lartpërmendur kishin në përdorim të lirë xhaminë e Pargës dhe imami i saj shfrytëzonte tokën e xhamisë që i ishte njohur nga Banka Kombëtare e Greqisë qysh në vitin 1925. Qeveria greke deklaroi se, me përjashtim të familjeve, statusi i të cilave kishte qenë në diskutim, popullsia myslimane e Pargës, që përbëhej nga 700 persona, ishte përfshirë në shkëmbimin e popullsisë greko-turke dhe, për rrjedhojë, disa prona ngjitur me xhaminë kishin qenë vendosur nën kontrollin e Bankës Nacionale të Greqisë, pasi formonin një pjesë të pronave që ishin përfshirë në skemën e shkëmbimit. Komisioni i Minoriteteve të LK vendosi që ta mbyllte këtë çështje, meqë nuk kishte pasur ankesa të reja nga popullsia e Pargës qysh prej petitionit që ajo kishte bërë para katër vjetësh.<sup>11</sup> Ky në fakt ishte një arsyetim absurd dhe qesharak.

Në të njëjtën kohë qeveria greke po vijonte spastrimin dhe dëbimin me anë të mjeteve të ndryshme edhe të pakicave të tjera. Si rezultat i politikave shtypëse të saj po vijonte një fluks i madh i emigrimit të vlllehëve nga krahina e Maqedonisë. Diplomati britanik në Athinë, Chick pohonte se 10.000 kuco-vlllehë po largoheshin për në Rumani. Ambasada britanike informonte Forin Ofisin se emigrimi i tyre po vijonte prej disa vitesh si rezultat i rrethanave që ishin krijuar me ndryshimin e legjislacionit grek dhe kufizimeve që u ishin bërë atyre për përdorimin e kullotave dhe pyjeve, duke e vështirësuar së tepërmi mbajtjen e tufave të bagëtive nga këta blegtorë. Për më tepër, instalimi i refugjatëve në Maqedoni e cila më parë ishte e mbushur nga kopetë e bagëtive të kuco-vlllehëve, e kishte kufizuar më tej sferën e tyre të veprimtimit. Gjithashtu Sër Patrick Ramsey pohonte se në këtë emigrim kishte një ndikim edhe propaganda rumune e cila po zhvillohej prej një kohe të gjatë dhe, që

---

<sup>11</sup> FO 371/15970, Notë e Sekretarit të Përgjithshëm të LK drejtuar anëtarëve të Këshillit të LK, mbi ankesën e banorëve të Pargës, Gjenevë, 17 maj 1932.

gjatë Luftës së Parë Botërore, ishte mbështetur edhe nga italianët. Ai kishte arritur në përfundimin se eliminimi gradual i vllahëve nga Maqedonia ishte një hap interesant dhe i rëndësishëm për zgjidhjen finale të ngatërresës maqedone.<sup>12</sup>

Për të mbajtur nën presion qeverinë shqiptare dhe për të ushqyer me nacionalizëm opinionin grek, qeveria e Athinës nxiti një fushatë intensive antishqiptare të shtypit vendas. Në verën e vitit 1930 shtypi grek shpërtheu një fushatë të re kundër dënimit të tre minoritarëve grekë me akuzën se kishin kërkuar nga qeveria greke financime për shkollat greke në Shqipëri. Shtypi grek i quajti akuzat të pa bazuara dhe burgimin e këtyre personave si të frymëzuar nga dëshira për të terrorizuar minoritetin grek në Shqipëri, shumë persona prej të cilit ishin detyruar që të largoheshin nga vendi prej persekutimit. Një delegacion i vorio-epirotëve u prit nga kryeministri grek më 19 korrik 1930 dhe një miting i madh u zhvillua në Athinë me 3 gusht të këtij viti në të cilin u kërkuua dërgimi i një komisioni të Lidhjes së Kombeve në Shqipëri.<sup>13</sup>

Siç u theksua më lart Lidhja e Kombeve mbajti një qëndrim disproporcional ndaj problemeve të minoriteteve greke dhe shqiptare në dy shtetet respektive. Por qëndrimi me dy standarde i organizmave të LK nuk u dëshmuua vetëm në problemet e ndërsjella minoritare midis Shqipërisë dhe Greqisë por edhe në çështjen e trajtimit të popullsisë shqiptare në Jugosllavi. Në shtator 1929 Komiteti i të Treve shqyrtoi një peticion të Hasan Prishtinës për persekutimin e popullsisë shqiptare nga qeveria jugosllave. Qeveria jugosllave ju përgjigj Këshillit të LK se ky peticion ishte i papranueshëm, duke u justifikuar se Hasan Prishtina kishte qenë një revolucionar dhe irredentist i angazhuar në aktivitete subversive kundër Jugosllavisë. Qeveria jugosllave deklaroi gjithashtu se ky peticion ishte në kundërshtim me parimin e përcaktuar në pikën 1 të rezolutës së Këshillit të 5 shtatorit 1923, e cila theksonte se peticionet nuk duheshin paraqitur në formën e një kërkesë për ndarjen e marrëdhënieve politike midis minoritetit dhe shtetit në të cilin ai bën pjesë. Gjithashtu qeveria jugosllave i paraqiti një memorandum Këshillit të LK, me 21 gusht 1929, në të cilin mohoheshin akuzat e H. Prishtinës dhe deklarohesh se në Jugosllavi ekzistonte një numër i madh shkollash

---

<sup>12</sup> FO 371/15970, Sër Patrick Ramsey nga Athina për Sër John Simon në Forin Ofis, 12 dhjetor 1932.

<sup>13</sup> FO 371/14302, Oliver Harvey për Arthur Henderson, Athinë, 5 gusht 1930.

me klasa të veçanta për fëmijët shqiptarë.<sup>14</sup> Komiteti vendosi, që në bazë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të qartë të akuzave që ishin bërë në peticion, duke pasur parasysh personalitetin dhe qëndrimin e autorit të këtij peticioni, si dhe duke marrë në konsideratë përgjigjen e detajuar dhe të kënaqshme të qeverisë serbo-kroato-slllovene, nuk duhej ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë çështje. Megjithëse trajtimi i kësaj çështjeje u bë në mënyrë krejt të përciptë, Komisioni vuri në dyshim vetëm atë pjesë të përgjigjes jugosllave ku jepeshin statistika mbi numrin e shkollave me “klasa speciale” për fëmijët shqiptarë, por nuk ishte e qartë që këto klasa speciale u ofronin fëmijëve shqiptarë plotësisht lehtësitë e përcaktuara nga Traktati i Minoriteteve. Pasi i shkroi përfaqësuesit serbo-kroato-sllloven, Drejtori i Seksionit të Minoriteteve mori garanci se shkollat e lartpërmendura ishin në përputhje me këto standarde.<sup>15</sup> Në fakt ky ishte një mashtrim aspak i hollë dhe lehtësisht i verifikueshëm nga organizmat e LK, të cilave u mungonte tërësisht vullneti për ta hetuar situatën në terren.

Shqipëria jo vetëm ndoqi një politikë liberale dhe mirëkuptimi ndaj minoriteteve por si organizmat shtetërore ashtu edhe ato joqeveritare demonstuan në institucionet e në konferencat ndërkombëtare një frymë të spikatur liberale për qëndrimin ndaj minoriteteve.

I tillë ishte qëndrimi i delegacionit shqiptar në Lidhjen e Kombeve. Në takimin e Komisionit Politik të Lidhjes së Kombeve, që u zhvillua në Gjenevë më 20 shtator 1930, kryetari i delegacionit shqiptar, Mehdi Frashëri kërkoi që të formohej një Komision i Përhershëm i Lidhjes së Kombeve për të ndjekur problemet e minoriteteve<sup>16</sup>. Ky ishte një propozim shumë liberal. Mirëpo ai u kundërshtua nga përfaqësuesit franko-britanike, të cilët në këtë periudhë ndiqnin një politikë konservatore kundrejt të drejtave të minoriteteve. Përfaqësuesi francez Briandi, theksoi se, pakicat kishin të drejta të kombinuara dhe procedura ekzistuese për mbrojtjen e tyre, e miratuar unanimisht, jepte të gjitha garancitë për të zgjidhur me drejtësi të plotë ankesat individuale.

<sup>14</sup> FO 371/13711, Shënime të Forin Ofisit, 5 dhjetor 1929; Memorandum i Balfour për Forin Ofisin, 5 dhjetor 1929 rreth veprimeve të kryera nga Këshilli i LK lidhur me memorandumun e H. Prishtinës.

<sup>15</sup> FO 371/13711, Delegacioni britanik në Gjenevë, Rekord i takimit të Komitetit të Minoriteteve mbajtur në Gjenevë më 18 shtator 1929.

<sup>16</sup> “Çështja e pakicave përpara Lidhjes së Kombeve”, *Ora*, Tiranë, 21 shtator 1930.

Ndërsa lidhur me propozimin e Mehdi Frashërit, Briandi pohoi se reklamimi kolektiv i problemeve të minoriteteve nga Komisioni Permanent shumë shpejt do të rrezikonte paqen. Këtë pikëpamje e përkrahën edhe përfaqësuesi i Çekosllovakisë, Benesh dhe ai i Rumanisë Antoniade. Ndërsa përfaqësuesi i Hungarisë, Appony përkrahu propozimin e Mehdi Frashërit<sup>17</sup>.

Ndërkohë debati në Lidhjen e Kombeve vazhdonte i pandërprerë, herë i drejtpërdrejtë e herë i tërthortë, ku grekët dhe jugosllavët, nën pretekstin e mbrojtjes së minoriteteve, po përpiqeshin të pengonin dhe deformonin procesin e konsolidimit të institucioneve kombëtare shqiptare. Ndonëse Lidhja e Kombeve kishte dështuar tërësisht për të mbrojtur të drejtat e minoriteteve shqiptare në Greqi e në Jugosllavi, nuk ngurronte të ishte e rreptë dhe ekzigjente ndaj të gjitha akuzave që parashtronin grekët dhe jugosllavët ndaj qeverisë shqiptare për trajtimin e minoriteteve apo për probleme të tjera. Kështu, në shtator të vitit 1932, Sekretari i Lidhjes së Kombeve Eric Drumond i shprehu ankesa e dyshime përfaqësuesit shqiptar në këtë organizëm për ndërhyrjen e qeverisë shqiptare në çështjen e kishës ortodokse në Shqipëri dhe për disa incidente që kishin ndodhur në Delvinë. Ai pohoi se qeveria shqiptare, “për të respektuar zotimet e marra në LK, duhej të mos ndërhynte në besimin fetar të grekofonëve dhe të mos i burgoste këta njerëz”<sup>18</sup>.

Përfaqësuesi i Shqipërisë u përgjigj se Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare ishte krijuar nga shqiptarët ortodoksë që jetonin në kolonitë e ndryshme qysh në vitin 1908 dhe nuk ishte aspak e vërtetë se ajo ishte një sajesë e qeverisë shqiptare. Gjithashtu ai e informoi Sekretarin e Përgjithshëm se myslimanët nuk i kishin prishur ceremonitë fetare, por ngatërresat ishin shkaktuar nga njerëz të organizatave vorio-epirote, kur lutjet në kishë po bëheshin në gjuhën shqipe. Qeveria nuk kishte marrë masa kundër besimit të këtyre njerëzve por vetëm për të ruajtur qetësinë dhe rregullin. Ai i sugjeroi në mënyrë të qartë Drumondit se, “sa për respektin që kemi ndaj angazhimeve tona, jemi gati të pranojmë një komision anketimi të LK. Atëherë do të shihni se ndaj 60 shkollave grekofone që janë hapur dhe ndaj gjithë lehtësirave fetare e komunale që u janë siguruar grekofonëve në Shqipëri, të cilët kanë edhe deputetë,

<sup>17</sup> Po aty.

<sup>18</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), viti 1932, dos. 118, fl. 9-11, Informacion i përfaqësuesit të Shqipërisë në LK mbi takimin me Eric Drumondin, më 7 shtator 1932.*

shqiptarëve të Greqisë nuk u është njohur asnjë e drejtë, nuk kanë asnjë shkollë, asnjë deputet. Në ushtrinë dhe në administratën greke nuk ekziston asnjë nëpunës shqiptar”<sup>19</sup>. Propozimin e anketimit Drumondi e cilësoi si shenjën më të qartë të sigurisë që kishte qeveria shqiptare në sjelljen e saj korrekte dhe shtoi se ky propozim ishte i mjaftueshëm për të ndriçuar opinionin e Komisionit të Posaçëm të Minoriteteve. Ai deklaroi: “Natyrish, që shqiptarët kanë plotësisht të drejtë të rregullojnë e të ngrenë kishën e tyre kombëtare. Këtu askush nuk mund të përzihet. E vetmja gjë që kërkojmë është mosndërrhyrja në besimin e të tjerëve”<sup>20</sup>.

Diferencat parimore midis shqiptarëve dhe grekëve u dukën edhe në nivelin e konferencave ndërkombëtare të institucioneve jo qeveritare. Trajtimi i kësaj çështjeje është me interes për të parë edhe tendencat e inteligjencies së të dy vendeve megjithëse duhet theksuar në mënyrë kritike se në këtë periudhë nuk mund të flitet për organizma të pastra të shoqërisë civile të pavarura drejtpërdrejt apo tërthorazi nga politika.

Një qëndrim liberal ndaj minoriteteve dhe këmbëngulje për garantimin dhe kontrollin e rreptë të zbatimit të traktateve ndërkombëtare që përcaktonin të drejtat e tyre mbajtën edhe delegacionet jo qeveritare shqiptare në konferencat ballkanike, të cilat u mbledhën për të diskutuar problemet e bashkëpunimit ballkanik dhe krijimin e një pakti ballkanik. Konferenca e parë Ballkanike ishte parashikuar të zhvillohej në Athinë. Mirëpo delegacioni bullgar, pasi u informua se në këtë konferencë nuk do të diskutohej çështja e pakicave, deklaroi se nuk do të merrte pjesë. Çështja u diskutua edhe midis anëtarëve të delegacionit shqiptar në një mbledhje të zjarrtë që u zhvillua në shtëpinë e kryetarit të tij Mehmet Konicës<sup>21</sup>. Delegacioni u nda në dy pjesë – “ekstremistët”, që ishin pjesa më e madhe dhe që kundërshtuan vajtjen në Athinë në qoftë se nuk do të diskutohej çështja e minoriteteve, dhe “te moderuarit”, që bënë thirrje për një qëndrim më të kujdesshëm. Ky qëndrim reflektonte interesat e kombit shqiptar i cili ishte shumë i interesuar për mbrojtjen e shqiptarëve etnikë në Jugosllavi e Greqi. Moderatorët këmbëngulën që të mos imitohej qëndrimi i delegacionit bullgar dhe të merrnin pjesë në konferencën e Athinës. Gazeta “Ora” shkruante se qëndrimi për të

<sup>19</sup> *Po aty.*

<sup>20</sup> *Po aty.*

<sup>21</sup> “Disa anëtarë të Komisionit për në Konferencën Ballkanike e kthyen mendimin për të vajtur në Athinë”, *Ora*, Tiranë, 1 tetor 1930.

bojkotuar Konferencën e Athinës bëri përshtypje jo të mirë në qarqet e ndryshme të kryeqytetit shqiptar<sup>22</sup>.

Delegacioni shqiptar i dërgoi një telegram kryetarit të konferencës, Papanastasiut, të cilit i kërkoi shpjegime për rendin e ditës së konferencës. Përgjigja e kryetarit të konferencës u gjykua e favorshme, kështu që më 2 tetor 1930 delegacioni vendosi të merrte pjesë në konferencën e Athinës<sup>23</sup>. Delegacioni shqiptar kryesohej nga Mehmet Konica, Gjergj Fishta nënkryetar, dhe anëtarë ishin Imzot Gj. Bonati, Emine Toptani, Stavro Stavri, Leonidha Naçi, Fazlli Frashëri, Said Toptani, Asim Jakova dhe M.Bushati. Gjatë konferencës së Athinës delegacioni shqiptar, si në mbledhjet e përgjithshme ashtu dhe në ato të Këshillit të Konferencës, punoi aktivisht për afirmimin e pikëpamjeve të veta në mbrojtje të minoriteteve. Me gjithë situatën e pafavorshme lidhur me trajtimin liberal të minoriteteve, si rezultat i dominimit të nacionalizmit shoven në skenën ballkanike të asaj kohe, delegacioni shqiptar arriti që ta fuste çështjen e pakicave në rendin e ditës së konferencës së ardhshme<sup>24</sup>.

Një vit më vonë, delegacioni shqiptar këmbënguli sërish që vendet ballkanike të respektonin të drejtat e pakicave. Mehmet Konica i dërgoi një letër kryetarit të Konferencës Ballkanike, në të cilën kritikonte shtetet ballkanike për qëndrimin jo tolerant ndaj pakicave. Përballë politikave nacionaliste të këtyre shteteve, ai vinte politikën e shtetit shqiptar, në të cilin pakicat, “qysh prej krijimit të këtij shteti, gëzonin jo vetëm të drejtat e pakicave por edhe të gjitha të drejtat që gëzonin qytetarët shqiptarë, pa kufizimin më të vogël”<sup>25</sup>.

Ai nënvizonte se Shqipëria kishte të drejtë të kërkonte prej fqinjëve të saj reciprocitetin, kur traktatet nuk merreshin parasysh. “Kur pakicat po zhduken – theksonte ai, - është e vështirë që Shqipëria të vazhdojë të marrë pjesë në Konferencën Ballkanike. Ai paralajmëronte se në konferencën e ardhshme ballkanike dërgata shqiptare do të kërkonte njohjen e të drejtave të pakicave etnike dhe marrjen e masave përkatëse për t’i garantuar këto të drejta”<sup>26</sup>.

<sup>22</sup> Po aty.

<sup>23</sup> “Komisioni vendosi të marrë pjesë në Konferencën Ballkanike”, *Ora*, Tiranë, 2 tetor 1930.

<sup>24</sup> “Një komunikatë sqaronjese”, *Miku i Popullit*, 18 shtator 1931.

<sup>25</sup> “Shqipëria dhe Konferenca Ballkanike”, *Gazeta e Korçës*, 11 shtator 1931.

<sup>26</sup> Po aty.

Grupi Kombëtar Shqiptar zhvilloi para se të mblidhej konferenca një polemikë të hapur me Grupin Kombëtar Jugosllav për çështjen e bashkimit ballkanik dhe të pakicave. Grupi jugosllav, në memorandumimin e tij, u shpreh kundër Federatës Ballkanike dhe akuzoi Shqipërinë se ishte vënë në shërbim të Italisë, e cila do ta përdorte territorin shqiptar për të përgatitur luftën kundër Jugosllavisë. Ai kërkonte të aplikohet parimi “Ballkani për ballkanasit”<sup>27</sup>. Grupi Kombëtar Shqiptar e shpjegoi këtë qëndrim të jugosllavëve me faktin se Jugosllavia nuk donte të njihete të drejtat e minoriteteve. Ai deklaroi se “kushtet e afrimit politik midis kombeve ballkanike përmblihen në çarmatimin moral dhe çarmatimi moral nuk mund të përfitojë përveçse duke njohur dhe zbatuar të drejtat e pakicave”<sup>28</sup>.

Në Konferencën Ballkanike, Mehmet Konica deklaroi se “shteti shqiptar ishte partizan i zjarrtë i bashkimit ballkanik, të bazuar në parimet e drejtësisë dhe miqësisë së plotë, dhe nuk do të ishte e mundur të bëhej ndonjë hap në këtë drejtim pa u njohur të drejtat e pakicave”<sup>29</sup>.

Në prag të Konferencës, shtypi shqiptar, thujse njëzëri, kërkoi prej delegacionit shqiptar që të parashtronte në themel të bashkëpunimit ballkanik respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve. Gazeta “Ora” shkruante: “Pas pak ditësh do të shohim nëse shpresa e ngjallur për rritjen e lules së paqes në sheshet e mbytura me gjak të Ballkanit i ka rrënjët mjaft të shëndosha sa të mos fishket nga ajri i helmatisur i urrejtjeve, mosbesimeve dhe rivaliteteve. Por që të jetë më i fortë probabiliteti, se ajo lule do të rritet e madhohet, duhet pastruar më parë sheshi i mbjellë nga gjembat, ferrat dhe drizat e helmuara. Barishtet më të egra që e bëjnë të pamundshme rrënjosjen e asaj luleje janë ankimet gjer në qiell të pakicave të munduara e të shtypura. Po të mos zhduken këto ankime, po të mos u njihet me gjithë mend e me gjithë zemër pakicave e drejta e lirisë së ndërgjegjes kombëtare, me gjithçka përfshin ai parim i garantuar prej mjaft traktateve ndërkombëtare, çdo shpresë për një afrim ndërbalkanik ose edhe për vazhdimin e bisedimeve në atë drejtim është

<sup>27</sup> “Pretendimet Jugosllave dhe përgjigja e Grupit Kombëtar Shqiptar”, *Gazeta e Korçës*, 18 shtator 1931.

<sup>28</sup> Po aty.

<sup>29</sup> “Deklaratat e para të delegatëve të Konferencës Ballkanike”, *Gazeta e Korçës*, 24 tetor 1931.

fatalisht një utopi, një absurditet, një monstruoze”<sup>30</sup>. Pa zbatimin e këtij parimi, e në këtë kuadër, edhe dhënien e të drejtave pakicave shqiptare në Jugosllavi e Greqi, deklaratat për afrimin e vëllazërimit ballkanik do të kishin po atë kuptim si deklaratat e xhonturqve për vëllazërimitin e popujve të Perandorisë Osmane, domethënë “vëllazërim” me anë të shkombëtarizimit, i cili sjell me vete gjithë tmerret dhe lemeritë e shfarosjes. Prandaj i kërkohej delegacionit shqiptar që të parashtronte, si një konditë *sine qua non*, për pjesëmarrjen në konferencë, njohjen e të drejtave të pakicave shqiptare, së paku në masën që u ishin njohur prej traktateve ndërkombëtare<sup>31</sup>.

Para nisjes për në Konferencë Mbreti Zog priti delegacionin shqiptar, të cilin e porositi veçanërisht që të përpiqej për mbrojtjen e minoriteteve shqiptare në Jugosllavi e Greqi, duke theksuar se “duhet të tregohemi vërtet modestë, si shtet i vogël që jemi, por në mbrojtjen e shqiptarëve përtej kufijve, lypset të tregojmë energji më të madhe”<sup>32</sup>. Gazeta “Miku i Popullit” shprehej skeptike për vullnetin e shteteve fqinje që të respektonin të drejtat e pakicave dhe vendoste përballë kësaj intrasigjence shembullin e Shqipërisë, duke cituar edhe një artikull vlerësues të gazetës prestigjioze “Journal de Genevë”, i cili e cilësonte politikën e shtetit shqiptar ndaj pakicave si shembullore, që duhej marrë si model nga gjithë shtetet e tjera<sup>33</sup>.

Konferenca Ballkanike që u zhvillua në Stamboll, pati debate të nxehta për çështjen e pakicave. Përfaqësuesi grek, Papanastasiu propozoi një pakt ballkanik mossulmimi, arbitrazhi dhe ndihme reciproke, i cili prekte në mënyrë të veçantë çështjen e minoriteteve. Projekti grek u kundërshtua rreptësisht prej delegacionit bullgar dhe atij shqiptar, të cilët këmbëngulën që të gjendej një mënyrë, e cila të zgjidhte sa më shpejt problemin e pakicave, sipas parashikimit të traktateve dhe sipas parimit të bashkimit vëllazëror të popujve ballkanikë. Kundërshtimet u bënë të mprehta sepse delegacionet shqiptare e bullgare kërkuan që të hidhej poshtë projekti grek. Konferenca u bllokua përkohësisht, deri kur përfaqësuesi bullgar Sakazov propozoi që projekti të shqyrtohej nga një komision i posaçëm, i cili do t’i paraqiste një raport Këshillit të

<sup>30</sup> “Delegata jonë në Stamboll duhet të mbrojë dinjitetin e shtetit dhe interesat e pakicave”, *Ora*, Tiranë, 17 tetor 1931.

<sup>31</sup> Po aty.

<sup>32</sup> “Konferenca e Stambollit”, *Miku i Popullit*, 23 tetor 1931.

<sup>33</sup> Po aty.

Konferencës së ardhshme Ballkanike tre muaj para se ajo të mblidhej<sup>34</sup>. Në Konferencë, Mehmet Konica zhvilloi një polemikë të ashpër edhe me përfaqësuesin serb. Ai kërkoi që të mos diskutohej projekti i Paktit Ballkanik pa zgjidhur më parë çështjen e minoriteteve<sup>35</sup>.

Në çeljen e konferencës Mehmet Konica deklaroi<sup>36</sup>: “Ne po e kërkojmë këtë në emër të njerëzimit, në emër të drejtësisë elementare dhe sepse kjo është baza e vetë marrëveshjes ballkanike. Nuk duhet të kemi iluzione, pa njohjen dhe zbatimin e të drejtave të pakicave, ne nuk do të mundim të përparojmë asnjë hap. Fjala se njohja e të drejtave të pakicave do të përbënte një rrezik për vendin ku ato rrojnë, është një argument që nuk qëndron në këmbë. Shqipëria ka dhënë provën e të kundërtës. Që nga krijimi i saj si shtet i pavarur, pakicat që jetojnë në gjirin e saj, jo vetëm që gëzojnë të gjitha të drejtat e parashikuara prej traktateve, por, ashtu si nënshtetasit e racës shqiptare, marrin pjesë në të gjitha degët administrative të shtetit, pa më të voglin kufizim. Ja pra, ne nuk po shohim asnjë rrezik që mund të na kanoset nga ana e këtyre pakicave. Rreziku do të ekzistonte pa dyshim në qoftë se sillemi ndaj këtyre minoriteteve sikur të ishin ilotë (të mundur, robër lufte). Është pretenduar shpesh se më parë duhen zgjidhur çështjet e kollajta. Unë nuk jam i këtij mendimi. Kur njeriu do të ndërtojë një shtëpi, nuk fillon nga dyert e nga penxheret, por nga themelet. Themelet e shtëpisë së përbashkët që duam të ngremë vendosen me rregullimin e të drejtave të pakicave. Është një gjë e mërzitshme të konstatojmë se në Ballkan ka drejtues që nuk duan të marrin parasysh realitetet, nuk duan t’i shohin rreziqet që na kanosen e nuk mund të kuptojnë se po marrin mbi vete përgjegjësi të tmerrshme, sa kundrejt vendeve të veta aq edhe ndaj vendeve të tjera ballkanike, kur na ngatërrojnë rrugën që shpie në shpëtimin e popujve, duke u refuzuar njerëzve të drejtat e natyrshme të tyre”.

Në Konferencën e Stambollit pati një diferencë të qartë pikëpamjesh. Grupi bullgar kërkoi garanci dhe krijimin e një instrumenti të ri efektiv për mbrojtjen e minoriteteve dhe për zbatimin e barabartë të këtyre parimeve nga shtetet ballkanike. Ndërsa përfaqësuesit jugosllav e injoruan problemin e minoriteteve. Ata e vunë theksin në “frenimin e ndërhyrjeve në jetën e brendshme të shteteve fqinj, pengimin e krijimit të

---

<sup>34</sup> “Veprimet e Konferencës Ballkanike të Stambollit”, *Shqipëria e Re*, 4 nëntor 1931.

<sup>35</sup> Po aty.

<sup>36</sup> “Nga Konferenca e Istambullit”, *Miku i Popullit*, 15 nëntor 1931.

aleancave me shtete jashtë ballkanike dhe zbatimin e plotë të parimit “Ballkani për ballkanasit”<sup>37</sup>.

Pala shqiptare propozoi krijimin e gjashtë komisioneve të përhershme pranë gjashtë vendeve ballkanike për studimin e gjendjes së pakicave, me qëllim që të sigurohej zbatimi i traktateve për pakicat. Anëtarët e këtyre komisioneve do të emëroheshin prej qeverive përkatëse. Ndërsa delegati grek propozoi krijimin e një komisioni të vetëm për studimin e kësaj çështje<sup>38</sup>.

Në fakt, çështja e mbrojtjes së pakicave ishte nënvizuar fort qysh në promemorien që grupi shqiptar ia kishte dërguar Kryesisë së konferencës në korrik të vitit 1931. Por kjo promemorie nuk u ishte komunikuar delegacioneve të tjera sepse Kryesia e kishte gjykuar promemorien shqiptare shumë të fortë, që mund të dëmtonte mbledhjen e Konferencës. Më 22 tetor 1931 Mehmet Konica e shpërndau këtë promemorie në Konferencë. Një ditë më vonë, Kryetari i Grupit Jugosllav, Joniç mbajti një fjalim të ashpër dhe e cilësoi promemorien shqiptare si fyese për shtetin jugosllav dhe të nxitur nga italianët. Grupi shqiptar denoncoi politikën jugosllave kundër shqiptarëve në Jugosllavi, të cilët nuk gëzonin asnjë nga të drejtat që u siguronte Pakti i Lidhjes së Kombeve.

Në mbledhjen e Komisionit Politik të 23 tetorit Papanastasiu propozoi që çështja e pakicave të kishte një vend të veçantë në Paktin për Federatën Ballkanike. Ajo duhej të studiohej, të thellohej e të zgjidhej nga organet përkatëse<sup>39</sup>. Ky propozim u pranua dhe kështu i mënjanoi diskutimet e mëtejshme rreth kësaj çështjeje, duke shmangur dështimin e plotë të Konferencës. Gjithashtu u vendos që Këshilli i Konferencës të formonte një komitet, i cili do të studionte paktin e Federatës, problemin e pakicave si dhe gjithë çështjet e tjera që pengonin afrimin ballkanik, duke marrë për bazë propozimet e bëra për problemin e pakicave.

Këmbëngulja e delegacionit shqiptar bëri që të pranohej teza se Pakti Ballkanik nuk mund të krijohej në qoftë se çështja e pakicave nuk do të zgjidhej më parë ose njëkohësisht me të dhe se këto ishin dy probleme të pandara nga njeri-tjetri. “Pakti bashkë me problemin e pakicave dhe jo veç e veç”, kjo qe teza shqiptare që fitoi<sup>40</sup>.

<sup>37</sup> AMPJ, viti 1931, dos. 52, fl. 196-207, Raport i Ihsan Libohovës mbi diskutimet në Konferencën e II Ballkanike, 1 dhjetor 1931.

<sup>38</sup> Po aty.

<sup>39</sup> Po aty.

<sup>40</sup> Po aty.

Shtypi shqiptar i bëri komente të ndryshme rezultateve të Konferencës së Stambollit. Një analizë realiste e të balancuar bënte gazeta “Miku i Popullit”, e cila shkruante: “Për ata që kujtonin se konferenca kishte për të vendosur përfundimisht dhe do të realizonte shpalljen e bashkimit ballkanik brenda 24 orëve, për ata konferenca nuk nxori gjë tjetër veçse ... sytë e saj”<sup>41</sup>. Mirëpo për njerëzit realistë që e njihnin gjendjen në Ballkan, konferenca vlerësohej jo shumë e kënaqshme por jo aq sa të bërtasim se falimentoi qëllimi i Konferencës. Gazeta vlerësohte pozitivisht formimin e komitetit të posaçëm që do të përpilonte Paktin Ballkanik, në të cilin do të merrej parasysh edhe çështja e pakicave. Gjithashtu, si një hap pozitiv, konsiderohej thyerja e rezistencës së delegacionit jugosllav, i cili kërkonte me këmbëngulje për të mos i diskutuar kurrë të drejtat e minoriteteve<sup>42</sup>.

Në të njëjtën kohë shtypi shqiptar zhvilloi polemika me shtypin grek e jugosllav, të cilët, siç e kemi përmendur më lart, sulmuan ashpër marrëveshjen e delegacioneve shqiptare e bullgare për trajtimin e pakicave në të dy vendet. Gazeta “Ora” shtronte pyetjen: “Ç’rrezik përbënte për afrimin ndërballkanik një marrëveshje për sigurimin e të drejtave të minoriteteve? Por a nuk është ky parimi esencial i inspirimit të bashkimit ndërballkanik? Ç’afirm ballkanik do të bëhet po të mos njihen të drejtat e pakicave në secilin prej shteteve të Ballkanit?” Ajo shkruante se, shqiptarët dhe bullgarët nuk kishin bërë gjë tjetër veçse kishin dhënë një shembull të dëshirës së tyre paqedashëse dhe bindjes ndaj vendimeve ndërkombëtare. “Me këtë frymë dhe jo me djallëzira duhet të ushqejnë opinionin publik edhe gazetat e dy fqinjëve grindavecë, nëse dëshirojnë sinqerisht t’i shërbejnë triumfit të idealit të marrëveshjes ballkanike”<sup>43</sup>.

Protokolli shqiptaro-bullgar u sulmua ashpër edhe në Konferencën Ballkanike të Stambollit, që i zhvilloi punimet nga 28 janari deri më 1 shkurt 1932. Pasi delegacioni bullgar i parashtrroi Këshillit të konferencës protokollin e lartpërmendur, delegacioni jugosllav i shpërndau Këshillit një material, ku përmbledheshin gjithë sulmet që kishte bërë shtypi grek dhe jugosllav kundër kësaj marrëveshjeje. Delegacionin jugosllav e ndihmoi edhe ai grek në bazë të udhëzimeve që kishte marrë nga MPJ e

<sup>41</sup> “Mbas konferencës”, *Miku i Popullit*, 1 nëntor 1931.

<sup>42</sup> Po aty.

<sup>43</sup> “Pse u dogji nepërkave greke e jugosllave?”, *Ora*, Tiranë, 26 janar 1932.

Greqisë<sup>44</sup>. Por debati që u zhvillua për këtë çështje provoi se protokollit shqiptaro-bullgar i Sofjes ishte i bazuar në parimet e Konferencës dhe në rekomandimet e saj për marrëveshje bilaterale. Me gjithë këtë, për të ulur tensionin në konferencë, delegacioni shqiptar propozoi tërheqjen e dy letrave të lartpërmendura dhe konsiderimin e tyre si të pa parashtruara në konferencë.

Pas kësaj filloi diskutimi për Paktin Ballkanik. Delegacionet greke e jugosllave pranuan ekzistencën e minoriteteve shqiptare në vendet e tyre dhe deklaruan se ishin marrë e do të merreshin masa për respektimin e traktateve të minoriteteve ndaj tyre. Kështu projekti i Paktit Ballkanik u pranua nga të gjithë delegacionet. Komisioni politik u ngarkua t'ia referonte Paktin, Konferencës III Ballkanike që do të mbledhej në Bukuresht<sup>45</sup>.

Delegacioni shqiptar i përbërë nga Mehmet Konica (kryetar), Gjergj Fishta (nënkryetar) dhe Leonidha Naçi (anëtar) mori pjesë në Konferencën Ballkanike, që i zhvilloi punimet më 22 deri 29 tetor 1932, në Bukuresht<sup>46</sup>. Disa muaj para se të mbledhej Konferenca e Bukureshtit, grupi shqiptar u informua se ministrat e Jashtëm të Jugosllavisë, Greqisë dhe Turqisë kishin deklaruar se në këtë konferencë nuk do të diskutoheshin çështje politike, por ajo do të merrej vetëm me problemet ekonomike, gjë që do të thoshte se problemi i Paktit Ballkanik dhe ai i minoriteteve nuk do të diskutoheshin. Delegacioni shqiptar u dërgoi pesë grupeve të tjera një letër në të cilën shpjegonte se, nëse nuk do të diskutoheshin projektet e Paktit, grupi shqiptar nuk do të merrte pjesë në konferencë. Katër grupet e tjera u përgjigjën se projektet e Paktit do t'i paraqitej konferencës<sup>47</sup>.

Dy muaj para se të mbledhej konferenca, grupi bullgar propozoi shtyrjen e saj sepse nuk kishte mundur të realizonte marrëveshjen dypalëshe me Jugosllavinë, Greqinë e Rumaninë për mbrojtjen e minoriteteve. Por pak ditë para Konferencës, ai pranoi të merrte pjesë në të. Propozimin e tij për marrëveshjet e lartpërmendura grupi bullgar e

---

<sup>44</sup> AMPJ, viti 1932, dos. 72, fl. 49-52, Raport i Mehmet Konicës mbi veprimtarinë e Këshillit për Konferencën Ballkanike në Stamboll prej 28 janar – 1 shkurt 1932, dt. 14 shkurt 1932.

<sup>45</sup> *Po aty*.

<sup>46</sup> *Po aty*, fl. 229.

<sup>47</sup> *Po aty*, fl. 261-264, Raport i Sekretarit të Delegacionit shqiptar, Leonidha Naçi për zhvillimin e Konferencës III Ballkanike në Bukuresht.

bëri në Konferencë. Por konferenca, me propozimin e grupit shqiptar, refuzoi pranimin e kërkesës bullgare, gjë që shkaktoi tërheqjen e delegacionit bullgar dhe qëndrimin e tij në konferencë vetëm në rolin e vëzhguesit.

Projekt-Pakti Ballkanik u pranua unanimisht nga Asambleja e konferencës dhe u vendos që ai t'u paraqitej qeverive ballkanike për ta shqyrtuar dhe për të dhënë një përgjigje për të para zhvillimit të Konferencës së IV Ballkanike, që do të mbledhej në tetor të vitit 1933. Grupi shqiptar deklaroi se, pa një përgjigje të këtyre qeverive, ai nuk do të merrte pjesë në konferencën e ardhshme<sup>48</sup>.

Konferenca e Bukureshtit diskutoi edhe problemet e bashkëpunimit ekonomik dhe mori vendime për krijimin e një komisioni, që do të përgatiste një projekt-traktat shumëpalësh, i cili do të bazohej në akordimin reciprok të taksave preferenciale, aplikimin e një politike të përbashkët për mbrojtjen e prodhimeve ballkanike në tregjet jashtë ballkanike dhe për shkëmbimin e mallrave me lehtësi midis ballkanasve<sup>49</sup>.

Në Konferencën Ballkanike të Selanikut, që u zhvillua në tetor të vitit 1933, delegacioni shqiptar, megjithëse ishte joqeveritar, u udhëzua nga qeveria shqiptare që të mbante një qëndrim më elastik dhe të bashkëpunonte me delegacionin turk e grek dhe, për disa çështje, edhe me delegacionin bullgar<sup>50</sup>. Në diskutimin e tij, Leonidha Naçi mbështeti nënshkrimin e një pakti ballkanik multilateral dhe nuk i vlerësoi marrëveshjet dypalëshe si të dobishme për idenë e bashkimit ballkanik. Ky qëndrim bëri përshtypje në konferencë sepse mendohej se grupi shqiptar do të mbante një qëndrim kundërshtues për vazhdimin e punimeve të konferencës. Këto dyshime u zhdukën më tej kur L.Naçi bashkëpunoi luajalisht me delegacionet turke dhe greke. Grupi shqiptar këtë herë heshti për çështjen e minoriteteve dhe pranoi pikëpamjen e Kryetarit të konferencës Papanastasiu, që kjo çështje do të diskutohej atëherë kur të vinte momenti i nënshkrimit të Paktit Ballkanik<sup>51</sup>. Ndoshta ky ndryshim i papritur i qëndrimit deri atëherë i vendosur në mbrojtje të

---

<sup>48</sup> *Po aty*, viti 1933, dos. 129, fl.2. Përmbledhje e raportit të grupit kombëtar shqiptar në Konferencën Ballkanike të Bukureshtit, 22-29 tetor 1932.

<sup>49</sup> *Po aty*.

<sup>50</sup> *Po aty*, fl. 94-97, Raport i Legatës Shqiptare në Athinë (Tahir Shtylla) – MPJ mbi Konferencën Ballkanike të Selanikut, 27 tetor 1933.

<sup>51</sup> *Po aty*.

pakicave erdhi pas presionit që po bënte Athina pas shtetëzimit të shkollave private të pakicës grekofone në Shqipëri.

Për këtë ndryshim të qëndrimit grupi shqiptar u kritikua në shtyp, veçanërisht nga gazeta “Besa”, e cila e quajti misionin e tij një dështim. Mirëpo grupi shqiptar u mbrojt, duke deklaruar se në gjithë konferencat e mëparshme ballkanike ai kishte luftuar shumë që në Paktin Ballkanik të afirmohej e drejta e minoriteteve. Kërkesa për të drejtat e minoriteteve dhe për fiksimin e tyre në Paktin Ballkanik u miratua në Konferencën e Bukureshtit. Aplikimi i vendimeve të saj iu la në dorë qeverive të vendeve të Ballkanit. Kështu që, në pritje të përgjigjeve që do të jepnin këto qeveri, nuk kishte arsye që t’i paraqitej Konferencës së IV Ballkanike të Selanikut përsëri kjo çështje për t’u diskutuar<sup>52</sup>.

Prej këtyre konferencave me përfaqësim joqeveritar, aq më tepër kur këto përfaqësi ballkanike ishin nën kontrollin e qeverive të tyre, nuk mund të pritej ndonjë gjë e madhe. Por për palën shqiptare konferenca pati rëndësi se ajo afirmoi kërkesat e saj paqësore dhe legjitime për respektimin e të drejtave të popullsisë shqiptare që kishte mbetur nën sundimin e Greqisë dhe Jugosllavisë. Aty delegacioni shqiptar pati rastin të demonstrojë me fakte dhe argumente politikë korrekte dhe liberale të shtetit shqiptar ndaj të drejtave të pakicave, një tablo kjo kontrastuese me politikë respektive të fqinjëve grekë dhe jugosllavë. Këto koncepte të ndryshme politike dhe intelektuale sollën edhe një debat të fortë midis delegacionit shqiptar dhe homologëve të tij fqinjë. U vendosën përballë njëri tjetrit konceptet liberale dhe humane shqiptare për minoritetet me ato nacionaliste dhe shovene të delegacioneve greke dhe jugosllave. Ky ishte një ballafaqim interesant dhe i pari në nivel jo qeveritar për mbrojtjen e minoriteteve.

---

<sup>52</sup> *Po aty*, fl. 46-47, Deklaratë e grupit shqiptar në Konferencën Ballkanike lidhur me kritikën e bëra në gazetën “Besa” më 12 prill 1933.

*S u m m a r y*THE GREEK – ALBANIAN DEBATE ON THE ISSUES OF THE MINORITIES  
AND THE ORTHODOX AUTOCEPHALOUS CHURCH OF ALBANIA IN THE  
INTERNATIONAL ORGANIZATIONS DURING 1928 - 1934

During 1929 – 1934, the Albanian government made great steps towards the consolidation of the national institutions. The consolidation and nationalization of the country's educational and religious institutions were part of this process. However, this process met with opposition and pressure by the neighbor countries, who were trying to prevent in every way its evolution and to spread their influence all over the Albanian territory, just as they had done in the past.

This article presents indications on the pressure exercised by the Greek government, in order to detain the Orthodox Autocephalous Church of Albania from affirming itself against the interventions of the Orthodox Church of Serbia in this conflict. It also deals with the diplomatic activity of the British government and legations on this matter.

Another element presented in this article is the position held by the Albanian non-governmental delegations in the Balkan Conferences on the cooperation in the Balkans and the creation of a Balkan pact. The Albanian delegation supported the minorities' rights by holding advanced positions.

